



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 1497/1 Prot.

Tiranë, më 04.03.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1778/1, datë 24.12.2021.

**SHOQËRISË “YLDON” SH.P.K**  
**Rruga “Qemal Stafa”, Nr. 382, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË**  
**MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “YLDON” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1778/1, datë 24.12.2021, për mineralin krom, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1110, datë 08.02.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 1497, Prot., datë 12.02.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1778/1, datë 24.12.2021, për mineralin krom, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit mineralar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2023.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1778/1, datë 24.12.2021, për mineralin krom, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1778/1, datë 24.12.2021, për mineralin krom, në Objektivin "Fushë Lopë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ENKELLEJDA MUÇAJ**

